



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 65, datë 17.03.2023

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË TETË PARAPRAKE TË 14 FAMILJEVE, QË KANË HUMBUR SHTËPITË INDIVIDUALE SI PASOJË E SHEMBJES NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE TË REJA

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019; VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar; VKM nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së tetë paraprake të 14 familjeve, që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, të cilët do të përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja, pasqyruar në Aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë

përbërëse e tij, hartuar nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 21.03.2023



ANEKSI I. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TE ZONAVE TE REJA

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PERBERJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESES	ZONA E RE
1	RRASHBULL	ISA	BAJRAM	RAMADANI	4	2+1	SPITALLE
2	RRASHBULL	BRIKENA	SHEFQET	ZYLFA	4	2+1	SPITALLE
3	RRASHBULL	NAMIR	RAMAZAN	GJECI	6	3+1	SPITALLE
4	RRASHBULL	BASHKIM	QERIM	XHERAHI	10	3+1	SPITALLE
5	RRASHBULL	LANDI	MUSA	BLETA	3	2+1	SPITALLE
6	RRASHBULL	DONIKA	MUSA	DACI	4	2+1	SPITALLE
7	RRASHBULL	NIKOLIN	MARK	PRENGA	4	2+1	SPITALLE
8	RRASHBULL	ALTIN	MUHARREM	ASLLANI	4	2+1	SPITALLE
9	KATUND I RI	QEMAL	REXHEP	ZIZAJ	5	3+1	SPITALLE
10	KATUND I RI	ISMAIL	MUHARREM	KURTI	3	2+1	SPITALLE
11	MANEZ	ALTIN	SEFER	LUKU	5	3+1	MANEZ
12	MANEZ	KAJE (ZENEL)	AHMET	DEDA	8	3+1	MANEZ
13	ISHEM	MUSTAFA	MUHARREM	SELI	3	2+1	SPITALLE
14	ISHEM	SELMAN	IMER	KAREPI	2	1-1	MANEZ





28/3/23 2702/4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 201/prot.
/q

Durrës, më 27.03.2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.65 datë 17.03.2023 “Për miratimin e listës së tetë paraprake të 14 familjeve që kanë humbur shtëpitë individuale si pasojë e shembjes nga tërmeti i datës 26.11.2019, të cilët do të përfitojnë nga programi i zhvillimit të zonave të reja”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

